



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS
DREJTORIA E MBIKËQYRJES SË STANDARDEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
NDIHMËS DYTËSORE
SEKTORI I MONITORIMIT TË OFRUESVE TË NDIHMËS JURIDIKE PARËSORE
DHE DYTËSORE

Nr. 1394 Prot.

Tiranë, më 09.10.2025

NJOFTIM PUBLIK

"PËR NJOFTIMIN E EKZEKUTIMIT VULLNETAR TË DETYRIMIT PËR Z. DRITAN ABAZAJ NË ZBATIM TË VENDIMIT NR.214, DATË 21.01.2025, TË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË"

Rr. "Misto Mame", Njësia Administrative nr.6, Tiranë

Referuar vendimit nr. 919 regj.them, datë 18.10.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku znj. Elda Allushi është përfituese e Ndihmës Juridike Dytësore, referuar procesit gjyqësor me objekt *"Kërkesë për përfitimin e ndihmës juridike dytësore dhe përjashtim nga taksat dhe tarifatat gjyqësore"*.

Me Vendimin nr.214, datë 21.01.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në procesin me palë paditëse znj. Elda Allushi dhe të paditur z. Dritan Abazaj me objekt *"Lëshimin e autorizimit për fëmijët Amla Abazaj e dt. 20.01.2019 dhe Tea Abazaj e dt. 14.05.2015 për daljen jashtë territorit të Shqipërisë, Marrjen e masës së përkohshme referuar nenit 139 të Kodit të Familjes, Dhënien e vendimit të Gjykatës me ekzekutim të përkohshëm në zbatim të nenit 317 të K.Pr.Civile"*, ka vendosur:

1. *Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditëses Elda Allushi;*
2. *Lëshimin e autorizimit për lëvizjen për një periudhë nga 15.06.2025 deri më 31.08.2025 jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në drejtim të Republikës së Gjermanisë të fëmijëve të mitur Amla Abazaj e dt. 20.01.2019 dhe Tea Abazaj e dt. 14.05.2015, në prezencë të nënës së tyre Elda Allushi, pa autorizimin e babait të fëmijëve, të paditurit Dritan Abazaj, pa cënuar mënyrën e takimit të babait me fëmijët.*
3. *Rrëzimin e kërkesës për pjsën tjetër të objektit të padisë.*
4. *Dhe në pikën 4 të dispozitivit të vendimit Shpenzimet gjyqësore i lihen në ngarkim palës paditëse.*

Në vendim gjykata shpreh që shpenzimet gjyqësore dhe shpenzimet për ekspert në masën 39 000 lekë të parapaguara nga pala paditëse janë në ngarkim të të paditurit.

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ka likujduar për shërbimin e ofruara ekspertin Arta Beqiri me vlerë 39 000 lekë.

Për sa më sipër, në mbështetje të Nenit 30 të Ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Kodit të Procedurës Civile, **ju lajmërojmë për kryerjen e ekzekutimit vullnetar brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit**, në zbatim të Vendimit nr. 214, datë 21.01.2025 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, të shumës prej 39000 lekë, të parapaguara nga ana jonë për shpërblim eksperti, ofruar për përfituesin e ndihmës juridike dytësore Falas znj Elda Allushi.

Shlyerja e ekzekutimit vullnetar të kryhet në llogarinë e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas më NIPT L11704452P.

Në rast se vendimi nuk ekzekutohet vullnetarisht, me kërkesë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, shërbimi përbarimor gjyqësor fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi.

Nga njoftimi i bërë nga shërbimi postar ka rezultuar i pamundur kontakti me z. Dritan Abazaj. Në këto kushte referuar nenit 148 e në vijim të Kodit të procedurës Administrative kur njoftimi është i pamundur, në respektim të të drejtave ligjore, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas vendosi që njoftimi të bëhet nëpërmjet shpalljes publike në këndin e njoftimeve në Bashkinë Tiranë, si dhe në faqen web të Drejtorisë. Ky njoftim duhet të qëndrojë jo me pak se 20 ditë. Njoftimi quhet i bërë kur Bashkia Tiranë depoziton në Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas një kopje të aktit bashkë me dokumentat që vërtetojnë shpalljen publike.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
NË MUNGESË**

**(DREJTOR I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE ADMINISTRIMIT
TË NDIHMËS PARËSORE)**

Patrieta Pogaçe

